

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. _____ Prot

Pogradec, më ____ . ____ . 2024

PROJEKT – VENDIM

NR. _____, DATË ____ . ____ . 2024


PËR MBARIMIN E MANDATIT PËRPARA AFATIT TË KËSHILLTARIT Z.DURIM TOSKA.

Në mbështetje të gërmës e, pika 3, nenit 49 të ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, gërma g, pika 1, e nenit 22, të VKB Nr. 40 datë 05.03.2020 “Rregullore për Këshillin Bashkiak Pogradec” me propozim të komisionit të mandateve Këshilli i Bashkisë:

VENDOSI:

1. T’ë deklarojë mbarimin e mandatit përpara afatit të Këshilltarit të Bashkisë Pogradec z.Durim Sali Toska i partise PSSH (Partia Socialiste Shqiptare) për shkak të mungesës në mbledhjet e Keshillit për një periudhë 6- mujore.
2. Për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e KQZ, ngarkohet sekretarja dhe Kryetarja e Këshillit.
3. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

KRYETARE E KËSHILLIT
Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. _____ Prot

Pogradec, më _____, 2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot, më datën _____ ndërmjet Komisionit të Mandateve, Rregulloreve, Çështjeve Juridike, Qeverisjes së Mirë, Administratës, Zgjedhjeve të Strukturave Komunitare, I Etikës, Konfliktit të Interesit, Standarteve dhe Apelimeve me përfaqësues, Kryetare Znj. Klea Topa, Nënkyetar Z. Klajdi Gjona, Sekretare Znj. Brunilda Gora, Anëtare Znj. Elsona Turshinka, Anëtar Z. Celnik Haxhillari, Anëtare Znj. Anila Gjoshe, Anëtar Z. Mentor Rama për procedurën e mbarimit të mandatit të Këshilltarit Bashkiak Z. Durim Toska, bazuar në Rregulloren e Funkcionimit të Këshillit Bashkiak miratuar me VKB Nr.40 ,datë 05.03.2020 dhe Ligjin Nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”.

Bazuar në listprezencën e mbajtur nga Sekretariati I Këshillit Bashkiak, Z. Durim Toska nuk ka qënë pjesë e Mbledhjeve të Rradhës së Këshillit Bashkiak që prej muajit shtator të vitit 2023 dhe në vazhdim. Mungesa e pjesëmarrjes në Mbledhjet e Këshillit Bashkiak për një periudhë 6-mujore është precedent për mbarimin e mandatit të Këshilltarit Bashkiak, Bazuar në Rregulloren e Brëndshme të Funkcionimit të Këshillit Bashkiak dhe Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

Sipas Rregullores së brëndshme të funksionimit të Këshillit Bashkiak, iu bëjmë me dije se nga ana e Z.Toska janë thyer pikat e rregullores si më poshtë vijon:



RREGULLORJA E FUNKSIONIMIT TE KESHILLIT BASHKIAK V 40 dt 05.03.2020.

Neni 22

Mbarimit të Mandati të Këshilltarit të Bashkisë

1. Mandati i Këshilltarit mbaron përpara afatit kur :

- a. ndryshon vendbanimin dhe regjistrohet si banor jashtë territorit të bashkisë Pogradec;
- b. jep dorëheqjen;
- c. krijohen kushte të papajtueshmërisë, të përcaktuara në nenin 47 të Ligjit nr. 139/2015;
- d. mandati, nga ana e tij është marrë në mënyrë të kundërligjshme;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. _____ Prot

Pogradec, më ____ . ____ . 2024

e. humbet zotësinë për të vepruar me vendim gjykatë;

f. vdes;

g. nuk merr pjesë në mbledhjet e këshillit për një periudhë 6-mujore;

h. dënohet për kryerjen e një vepre penale me vendim gjykatë të formës së prerë;

i. këshilli shpërndahet nga Këshillit të Ministrave.

j. në rast të konstatimit të kushteve për zbatimin e ndalimeve të parashikuara nga Ligji nr.

138/2015, neni 13) dhe shpalljes publikisht të rezulttit të verifikimit nga autoriteti i verifikimit, mandati i Këshilltarit Bashkiak përfundon menjëherë.


2. Në rast të konstatimit të kushteve për zbatimin e ndalimeve të parashikuara nga Ligji nr. 138/2015, neni 13 dhe shpalljes publikisht të rezulttit të verifikimit nga autoriteti i verifikimit, mandati i Këshilltarit Bashkiak përfundon menjëherë.

3. Anëtarit të Këshillit të cilit i është konstatuar kushti ndalues, pezullohet nga ushtrimi i funksionit për efekt të ligjit, dhe Këshilli mund të vendosë t'i heqë mandatin, në përputhje me Ligjin nr. 139/2015.

4. Kryetari i Këshillit, një grup prej minimumi 3 këshilltarësh dhe Kryetari i Komisionit të Mandateve mund të propozojnë për shqyrtimin e mbarimit të mandatit të këshilltarit nga Komisioni i Mandateve.

5. Propozimi paraqitet me shkrim, dhe duhet të përmbajë shkaqet ligjore për mbarimin e mandatit, dhe kur është e mundur dhe provat përkatëse. Propozimi depozitohet pranë Sekretarit të Këshillit. Sekretari njofton me shkrim Kryetarin e Komisionit të Mandateve dhe këshilltarin për të cilin propozohet mbarimi i mandatit.

6. Kryetari i Komisionit të Mandateve është i detyruar të thërrasë mbledhjen e Komisionit Brenda 7 ditëve nga data e marrjes së propozimit.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. _____ Prot

Pogradec, më ____ . ____ . 2024

7. Propozimi i Komisionit të Mandateve për mbarimin e mandatit, së bashku me dokumentet që provojnë shkaqet e mbarimit të mandatit për Këshilltarin, i paraqitet për diskutim dhe vendim-marrje Këshillit Bashkiak në mbledhjen më të afërt.
8. Komisioni i Mandateve njofton këshilltarin brenda 5 ditëve nga data e mbledhjes së Komisionit ku është diskutuar kërkesa për mbarimin e mandatit të këshilltarit, për të paraqitur pretendimet e tij. Këshilltari brenda 10 ditëve nga dita e marrjes së njoftimit nga Komisioni i Mandateve, dërgon në Komisionin e Mandateve arsyetimin ose fakte që kundërshtojnë mbarimin e mandatit. Në qoftë se brenda këtij afati 10 ditor, këshilltari nuk dërgon arsyetimin ose fakte e tij, Komisioni merr vendim dhe ia kalon për shqyrtim dhe miratim Këshillit Bashkiak.
9. Nëse Komisioni i Mandateve nuk i dërgon Këshillit raportin e miratuar në lidhje me propozimin e mbarimit të mandatit të këshilltarit, brenda 20 ditëve nga marrja e propozimit, propozuesi/t kanë të drejtë t'i dërgojnë Këshillit, jo më vonë se 5 ditë nga mbarimi i këtij afati, propozimin me dokumentet dhe shkaqet ligjore për mbarimin e mandatit të këshilltarit. Në këtë rast Këshilli ka detyrimin ta shqyrtojë propozimin në mbledhjen e tij të parë nga marrja e propozimit.
10. Vendimi i Këshillit për mbarimin e mandatit të këshilltarit përmban mendimin e shumicës dhepakicës.
11. Vendimi i Këshillit Bashkiak për mbarimin e mandatit i njoftohet këshilltarit brenda 5 ditëve dhevendin e tij e zë kandidati i radhës në listë shumëëmërore të subjektit politik ku bënte pjesë. Zëvendësimi kryhet sipas rregullave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor.
12. Nëse Këshilli nuk merr në shqyrtim apo nuk merr vendim për propozimin e Komisionit të Mandateveapo të këshilltarëve të përmendur në pikën "e" më sipër, për konstatimin e mbarimit të mandatit të këshilltarit, Sekretari njofton me shkrim Prefektin.
13. Mbarimi i mandatit para kohe i këshilltarit deklarohet me vendim të Këshillit Bashkiak, me propozim të Komisionit të Mandateve.
14. Heqja e mandatit të këshilltarit bëhet me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit.
15. Këshilltari nuk voton për mandatin e tij kur propozohet heqja e mandatit të tij.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. _____ Prot

Pogradec, më _____, _____ 2024

16. Në rastin kur këshilltari mungon për 6 muaj rresht në Mbledhjet e Këshillit, Sekretari i paraqet me shkrim Kryetarit të Këshillit raportin ku pasqyrohen data e mungesave, dhe ky fundit ia përcjell raportin Komisionit të Mandateve bashkë me kërkesën. Propozimi për heqjen e mandatit paraqitet nga Komisioni i Mandateve në mbledhjen e parë të rregullt të radhës të Këshillit. Në çdo rast, Kryetari i Këshillit bën përpjekje për të kontaktuar me këshilltarin për të kuptuar arsyet e mungesave.


Sipas Ligjit Nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", iu bëjmë me dije se nga ana e Z.Toska janë thyer pikat e rregullores si më poshtë vijon:

Ligj_nr.139-2015_date_17.12.2015_Per_vetqeverisjen_vendore.

Neni 49

Mandati i këshilltarit

1. Mandati i jepet këshilltarit me vendim të këshillit bashkiak.
2. Dhënia dhe heqja e mandatit bëhen me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit.
3. Këshilltari nuk voton për mandatin e tij.
4. Mandati i këshilltarit mbaron përpara afatit kur:
 - a) ndryshon vendbanimin jashtë territorit të bashkisë ku është zgjedhur;
 - b) jep dorëheqjen;
 - c) krijohen kushte të papajtueshmërisë, të përcaktuara në nenin 47 të këtij ligji;
 - ç) mandati, nga ana e tij, është marrë në mënyrë të kundërligjshme;
 - d) humbet zotësinë për të vepruar me vendim gjykatë;
 - dh) vdes;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. _____ Prot

Pogradec, më _____ . 2024

e) nuk merr pjesë në mbledhjet e këshillit për një periudhë 6-mujore;

ë) dënohet për kryerjen e një vepre penale me vendim gjykate të formës së prerë;

f) këshilli shpërndahet nga organi kompetent.

5. Mbarimi i mandatit para kohe deklarohet me vendim të këshillit bashkiak, me propozim të komisionit të mandateve.

Pas shqyrtimit të bazës ligjore të lartpërmendur, ju bëjmë me dije se mungesa juaj për një periudhë 6 mujore në mbledhjet e Këshillit Bashkiak është bërë precedent për përfundimin e mandatit të z.Durim Toska.

Duke iu falenderuar për mirëkuptimin!

KOMISIONI

Kryetar	Klea TOPA
Nënkryetar	Klajdi GJONA
Sekretar	Brunilda GORA
Anëtar	Elsona TURSHINKA
Anëtar	Çelnik HAXHILLARI
Anëtar	Anila GJOSHE
Anëtar	Mentor RAMA